

VENDIM
Nr. 792, datë 19.12.2024

**PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE FINANCIARE NDAJ TË TRETËVE TË
NDËRMARRJEVE SHTETËRORE USHTARAKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 3 dhe 4, të nenit 25, të ligjit nr. 88/2024, “Për krijimin e Shoqërisë Shtetërore për Prodhimin dhe Tregtimin e Armëve, Municioneve, Pajisjeve dhe Teknologjive Ushtarake”, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj të tretëve, në masën 290 000 000 (dyqind e nëntëdhjetë milionë) lekë, të ndërmarrjeve shtetërore Uzina e Lëndëve Plasëse Mjekës Elbasan, Uzina Mekanike Gramsh dhe Kombinati Mekanik Poliçan, nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, detajuar sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2024, për Ministrinë e Mbrojtjes, në programin buxhetor “Mbështetja e luftimit”.

3. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përfundon brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

**DETYRIME TE NDËRMARRJEVE TE RAPORTUARA ZYRTARISHT DHE
NDRYSHIME NE RAPORTIN E AUDITIMIT**

EMËRTIMI	SHKRESA	AKTI NORMATIV	AUDITUESI	NDRYSHIME
MJEKËSI				
Paga/sig.	13,304,113	13,304,113		
Taksa vendore	99,669,224	99,586,148		51307806
OSHEE	11,109,739	11,109,739		
Furnitor	3,737,734			
Hua financiare	4,000,000			-4000000
Tatim fitim	2,550,000			
	134,370,810	124,000,000	181,678,616	47307806
POLIÇANI				
Furnitorët	500,000			
Overdrafte	6,812,000			
Pagat	1,936,459	1,936,459		
Sig. shoq./shëndet.	644,475	644,475		
Tatim mbi pagat	114,734	114,734		

Tatim fitimi	75,000			
TVSH	9,223,546	497,967		
Tatime të tjera tatimore	28,838,226	28,838,226		
Debitore kreditore të tj. përmbartimore	143,027,815	67,500,000		
Tatime të shtyra taksa lokale	22,469,006	22,469,006		
Detyrime të gjeneruara nga sistemi I DPT	1,000,000	1,000,000		
DRTRR	420,971			
OSHEE	102,499,133	34,999,133		
MM	1,040,926			-1040926
POSTA	33,653			
MEICO	1,637,818			-1637818
	320,273,762	158,000,000	317,595,018	-2678744
GRAMSH				RAPORT AUDITI
Furnitorët	3,865,239		(3,115,239)	750000
Pagat	5,206,993	5,206,993	500,000	5706993
Sig. shoq./shëndet.	1,367,667	1,367,667	-	1367667
Tatim mbi pagat	124,409	124,409	-	124409
TVSH	3,815,554		105,012	3920566
Tatime të shtyra taksa lokale	16,222,422	1,300,931	-	16222422
Detyrime të mbartura Kamatëvonesa	900,000		264,440	1164440
OSHEE			3,091,455	3091455
POSTA			4,286	4286
MEICO				3156258
UJËSJELLËS			796,066	796066
PERSON FIZIK			20,000	20000
	31,502,284	8,000,000	33,168,304	1,666,020
T O T A L I	486,146,856	290,000,000	532,441,938	36,324,562

Ndërmarrja	Detyrime ndaj personelit	Detyrime ndaj të tretëve	Detyrime ndaj institucioneve shtetërore	Likuidimi sipas AN nr. 3, datë 28.08.2024, në vlerë
Uzina e Lëndëve Plasëse, Mjekes	13,304,113	11,109,739	89,586,148	114,000,000
Uzina Mekanike Gramsh	7,199,069	2,000,000	8,800,931	18,000,000
Kombinati Mekanik Poliçan	2,695,668	102,499,133	52,805,199	158,000,000
Shuma	23,198,850	115,608,872	151,192,278	290,000,000